

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE
“A&A CONSTRUCTION” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 3./12/2022 (dym i jenjëzotëdy):

- **Z.Arian SEFERI**, shtetas shqiptare, i datës indjes 08.01.1969, lindur në Republikën Çeke dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal G90108097E.
- **Z.Ardian MLIKA**, shtetas shqiptare, i datës lindjes 13.03.1974, lindur në Lezhë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal H40313038J.

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare “**A&A CONSTRUCTION**” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare “**A&A CONSTRUCTION**” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**A&A CONSTRUCTION**” SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshëm qe mund te kryeje një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e krijuar ne baze te legjisacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet herc pas herc dhe ne veçanti, por pa u kufizuar në;

- *Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen e ndertimit privat dhe publik. Germime dhei. Ndertime civile, industriale rtj. Rikonstrukione. Import - Eksport, me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem. Import - eksport me*



ose veprimitari që lidhet me çdo lloj pasurie të luajtshme ose të paluajtshme në përgjithësi.

Gjithashtu, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, çdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, si dhe çdo veprimitari me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që mund te konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës

NENI 2.

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do te paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj **“A&A CONSTRUCTION” SH.P.K.**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rr. “Kel Kodheli”, Nr.17, Tiranë.

NENI 3.

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

Ortakët e Shoqërisë mund të vendosи kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 4.

Regjimi Juridik i Shoqërisë.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhc dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të asamblesë së ortakëve, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve



përkatëse. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulen e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.

NENI 5.

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakut.

NENI 6.

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortaku jep kontributin e në shoqëri në para apo në natyrë, sipas nenit mënyrave dhe afateve të përcaktuara në këtë statut.

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtarë dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshire llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtarë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument ijetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përrapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm intercave tregtarë të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhë nuk tregon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjera. Ata gjëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpilen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të përcaktuara në nenin I.

Një person i cili është njëkohësisht ortak dhe administrator i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë. Mos përbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë. Kur kundërvajtja administrative e parashikuar në këtë pikë konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga administrata tatimore, sanksioni ekzekutohet nga kjo administratë.

NENI 7.

Abuzimi i ortakut ndaj shoqërisë

Ortaku i shoqërisë tregtare, mban përgjegjësi dhe përgjigjet personalisht, në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij për veprimet ose mosveprimet vijuese:

- a) abuzon me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajton pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paafësisë paguesc të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të sigruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimitarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

NENI 8.

Ndalimi i konkurrencës

Ortaku nuk mund të mbajë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimitari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ai nuk mund të mbajë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimitari në këtë sektor.

Nëse ortaku shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga deltyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimitarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund të kërkojë:

- a) të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përsitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

NENI 9.

Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi.

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e



përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhc likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërbuje shoqerinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhc/osc ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërbimin e dëmit të pësuar.

Në rastin c shoqërisë me një ortak të vetëm, ortaku i vetëm mund të kërkojë prishjen e saj dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese sipas kreut VI të këtij statuti. Largimi nga shoqëria dhe hapja e procedurave të likuidimit vendoset me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 10.

Përjashtimi i ortakut

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasoje e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit osc nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënive midis shoqërisë tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tijera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërbimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërbimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrëndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonë në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.

NENI 11.

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 12.

Kapitali i shoqërisë

Kapitali illestet i investuar nga Ortaku i vetëm, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon Ortakut dokumentin vërtetues për sasitë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.

NENI 13.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën prej 100,000 (njëqindmijë) lek.

Ortakët themelues të Shoqërisë zotërojnë kuotat si më poshtë:

1. **Arian SEFERI** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 51 % të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 51,000 (pesedhjete e nje mijë) lek.
2. **Ardian MLIKA** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 49% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 49.000 (dyzete e nente mijë) lek.

Kapitali themeltar është shlyer nga ortakët në total. Kontributi në kapital mund të jetë në para ose në natyre. Kontributi nuk të jetë në shërbime.

NENI 14.

Pasuria e Shoqërisë

Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kur vlera e pasurisë mbulohet tërsisht në të holla.

NENI 15.

Kalimi i pronësisë mbi kuotat.

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.



NENI 16.

Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave.

Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve ose ortakut të vetëm është i revojshëm, pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gjëzojnë të drejtën e parablerjes.

NENI 17.

Kalimi i kuotave të kapitalit fillestar duhet të verifikohet në përputhje me ligjin, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm.

Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhc të gjitha të drejta dhe detyrimet që i rrijedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anulimin e tyre.

Shoqëria mund të vendosë anulimin e kuotave të ortakëve në rastin e largimit ose përjashtimit të ortakut; pjesëtimit të kuotës ose zvogëlimit të kapitali. Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij statutit.

NENI 18.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Ortakët e Shoqërisë marrin vendime për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat e detyrueshme të ligji shqiptar dhe me dispozitat e këtij Statuti.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të ortakut/ortakëve.

Vendimi për zmadhimin e kapitalit regjistrohet në Qendrën Komëtare të Biznesit. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të tij në QKB.

Asambleja e përgjithshme/Ortaku i vetëm, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtu vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 19.

Fondet rezerve

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlycrien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 20.

Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kreditin për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët/ortaku i vetëm, sipas qellimeve të tyre.

NENI 21.

Bilanci, plani finanziar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë. Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar osc privat të këmbimit.

Shoqëria mban libra kontabël, harton e publikon të dhënat financiare dhe raportet përgjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuara në përputhje me ligjin përkontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

NENI 22.

Shpërndarja e fitimeve

Ortaku/ët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 23.

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund të japë fitimin ortakëve/ortakut të vëtëm, vetëm nëse pas pagimit të dividendifit:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon certifikatën e aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkeshat e mësipërme. Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të astësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortaku/ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e astësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

IV. ORGANET E SHOQËRISË.

NENI 24.

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte votave të ortakëve pjesëmarrës në rastet e mëposhtme:

1. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
3. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. Përcaktimin e shpërblimeve për administratoret, likuiduesit dhc ekspertët kontabël të autorizuar;
6. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
8. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
9. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
10. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Në rastin e shoqërisë me një ortak të vetëm të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.

NENI 25.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme të paktën 1 herë në vit.

Asambleja është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet në rastet e mëposhtme:

1. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori/ët apo ortaku/ët të cilët përsaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur. Në këto raste Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprinatarinë e administratorëve.

Në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm paragrafi i dytë i këtij nenit nuk zbatohen.

NENI 26.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 27.

Kuorumi i nevojshëm dhe vendimmarrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjegħimin e kapitalit të regjistruar, shpérndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë għixkatës të urdhérojé ndalimin e cenimit apo shpérblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 28.

Proċesverbal i mbledħjes se asamblesë dhe vendimet e ortakut tē vetëm

Tē gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet tē regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjen pér ruajtjen e kopjeve tē procesverbaleve tē mbledħjeve tē asamblesë së përgjithshme.

Procesverbalu duhet tē përbajċ daten e vendin e mbledħjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e tē mbajtësit tē procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkélidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbalu i mbledħjes nenhkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Në rastin e shoqërisë me një ortak tē vetëm tē gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistér tē vendimeve, tē dhénat e tē eilit nuk mund tē ndryshohen ose tē fshihen. Duhen regjistruar në veċanti, por pa u kufizuar nē to, vendimet pér:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë sō veprimtarisë;
- b) shpérndarjen e luti me vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet pér riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistrara nē regjistrin e vendimeve janë absolutisht tē pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë tē tretit, që ka fituar tē drejta nē

mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria pranon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 29.

Hetimet e posaçme

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçem për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e eksportit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin c'këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejtë për të kerkuar hetim të posaçem, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, kur këto përbëjnë shkelje të ligjit apo statutit. Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund ti kërkojë asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund të procedojnë vetë përpara gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi i asamblesë për ngrijen e padisë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar. Procedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfaqësues i posaçem i shoqërisë i emruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të përfaqësimin e tij jo nü interesin më të mirë të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhc shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 30

Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën



Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

- *Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Arian SEFERI, shtetas shqiptare, i datëlindjes 08.01.1969, lindur në Republiken Çeke dhe baues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal G90108097E*

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjeter publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përpunhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 31.

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përsaqësojë shoqérinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ccurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Kjo pikë nuk është e zbatueshme në rastet kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
10. regjistrojë të gjitha kontratat e lidhura midis tij dhe shoqërisë në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë. Mospërbmbushja e katill

detyrimi përbën kundërvajje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme/ortaku i vetëm cakton më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Një person i cili është njëkohësisht ortak dhe administrator i shoqërisë nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë.

Administratorët mbajnë përgjegjësi për veprimet e kryera për ushtrimin e funksioneve të tyre dhe janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo lëtim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregulla.

NENI 32.

Shpërbimi i administratorëve

Shpërbimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të janë përqindje në lëtim ose të ngjashme. Shpërbimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme. Shpërbimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përpunje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërbimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërbimit, shpërbimi individual dhe efekti vjetor i shpërbimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 33.

Ekspertët Kontabël.

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit finanziar kur jemi përparrë rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme/vendim i ortakut të vetëm.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.

Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive osc verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata dëri në shkallën e katërt.

VI. MARRDHËNIET E PUNËS.

NENI 34.

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 35.

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë përfundim faj të tyre dhe mbajnë përgjegjësi civile.

VI. PRISIIJA E SHOQËRISË. LIKUIDIMI.

NENI 36.

Kjo Shoqëri do të prishet në rast kur:

1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme/ortaku i vetëm;
2. hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar;
4. merret një vendim gjykate;
5. përfundon tregtarja, të parashikuara në statut;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 37.

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërite tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përfjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme/ortaku i vetëm. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim përmes emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, përfundimisht i caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyet e mjaftueshme përfundimisht se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kurrësa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.



Gjykata emëron likuiduesin, në raste kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.

Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.

Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhc tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënim "në likuidim".

Likuiduesit duhet të flojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve.

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhë detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 38.

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesvc është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të krycjë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 39.

Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme/ortaku i vetëm.

NENI 40.

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve.

Pas shpërrdarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për perfundimin e likuidimit që kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

NENI 41.

Likuidimi i thjeshtëzuar

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët/ortaku që kur këta deklarojnë përparrë gjykates përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njostojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 42.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 43.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 44.

Ky Statut hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

Arian SEFERI

Arian Seferi
Arian Seferi

Adrian MLJKA

Adrian Mlka
Adrian Mlka